



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 01./2010

Më 19. 01. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Nerxhivane Dauti Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha-Shala, Zef Morina dhe Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Myfera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Justina Pula - ministre e MEM-it, Besim Veseli - **Udh-Div** i MEM-it, Faik Nahu - këshilltar i MEM-it, Osman Hajdini - drejtor i DSSS-së, Ramadan Klisurica – KDI, Haxhi Gashi - USAID, Besim Zeqiri - ICO, Sagita Muco – ICO dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19. 01. 2010,
3. Shqyrtimi i Strategjisë së energjisë për periudhën 2009 – 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2009,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22. 12. 2009

Procesverbali i mbledhjes së datës 22. 12. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Strategjisë së energjisë për periudhën 2009 - 2010

Kryetarja e Komisionit - I përshëndeti te pranishmit. Fjalën ia dha ministres së MEM-it dhe kërkoi që në pika të shkurtra të jepte sqarime lidhur me Strategjinë e energjisë.

Justina Shiroka - Pula – ministre e MEM-it - Tha se Strategjia e energjisë për periudhën 2009 – 2018, të cilën e keni në rend dite është rishikim i Strategjisë së energjisë e realizuar në përputhje me Ligjin e energjisë, që e detyron rishikimin për çdo tre vjet. Mendoj se vëmendje duhet t'i kushtohet pjesës së dytë, që ka të bëjë me parashikimin e nevojave të reja për energji dhe me përmbushjen e kërkesave deri në vitin 2018. Qëllim themelor është të kemi furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. Strategjia parasheh ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe rehabilitimin e TC “Kosova B”, që të dyja me pjesëmarrje të sektorit privat. Në këtë strategji parashihet që edhe shfrytëzimi, edhe sigurimi i linjitet për kapacitete ekzistuese dhe ato të reja, prodhuese, të kalojnë në privatizim. Kjo strategji mendojmë se është e mbështetur në analizat e bëra dhe është reflektim i situatës aktuale. Strategjia i identifikon sfidat me të cilat ballafaqohet sektori energjetik, andaj edhe i orienton politikat më të përshtatshme për shndërrimin e tij në një sektor shumë të rëndësishëm ose jetik për Kosovën. Strategjia jonë është ta kemi një sektor të qëndrueshëm dhe të vetëfinancueshëm, që ofron shërbime ekonomikisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë. Kjo strategji i identifikon edhe politikat, edhe masat kryesore që duhen të ndërmerren për avancimin e reformave në sektorë të tjerë, që të mundësohet tërheqja e investimeve shumë të nevojshme nëpërmjet një procesi të hapur, transparent dhe konkursi për arritjen edhe të partneritetet publiko-privat. Strategjia e përcakton edhe krijimin e parakushteve të një tregu konkurrues të energjisë në pajtim me *aquis communautaire* të BE-së. Përcakton dhe ofron prodhim dhe shërbim të energjisë të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk e dëmton mjedisin dhe me kosto sa më të ulët. Përfundoi se kjo strategji është dhe paraqet të vetmen rrugë për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm energjetik për vendin tonë.

Osman Hajdini - përfaqësues i MEM-it - Tha se me këtë strategji për 2009 – 2018, janë bërë përshkrime dhe rishikime për kërkesa të reja për prodhimin dhe për furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike, si dhe për furnizimin e termocentraleve me linjit. Me këtë strategji janë hartuar objektivat themelore, siç janë ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe rivitalizimi i atyre ekzistuese. Strategjia synon menaxhimin efektiv të burimeve ekzistuese energjetike dhe mbrojtjen e mjedisit në pajtim me standardet e BE-së. Ministria e Energjisë është e pranishme dhe pjesëmarrëse në shumë forume ndërkombëtare, standardet e të cilave në parim janë inkorporuar edhe në këtë strategji. Rëndësi të veçantë në këtë strategji i kemi kushtuar mbrojtjes së mjedisit.

Ethem Çeku - Tha se kjo strategji nuk përputhet me realitetin në terren. Këtu janë dy çështje të kundërta. Nëse e marrim për bazë interesin e vendit, duhet të shtrohet pyetja sa janë resurset natyrore dhe sa janë nevojat për renovim të objekteve. Këtu kemi te bëjmë me dy koncepte: sa është nevoja për resurset natyrore për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe në anën tjetër sa është nevoja për renovimin e termocentraleve ekzistuese. Problem tjetër është se në çka është bazuar dhe cilat analiza i ka shqyrtuar Komiteti Drejtues për Strategjinë 2009 – 2018 për zvogëlimin e kapaciteteve. Në vazhdim tha se nëse vendoset për privatizimin e “Kosova B”, Kosova si shtet mbetet pa pronësi të energjisë. Duhet të punohet që të mos jetë në pakon e tenderimit të privatizimit. Theksoi se kompanitë e energjisë që privatizohen, në përcaktimin e çmimit të energjisë janë të pavarura. Nisur nga ky fakt, është e domosdoshme që shteti t’i ketë aksionet e veta. Qeveria kurrësi nuk duhet ta privatizojë “Kosovën B”, ngase do të krijohej monopol në treg. Ua përkujtoi të pranishëmve se në procedurën e shqyrtimit gjenden projektligjet bazë për energjetikë, pra do duhej që kjo strategji dhe ligjet përkatëse të shqyrtohen në mënyrë paralele dhe të plotësohen në frymë reciproke.

Justina Pula - Sa i përket “Kosovës B” e kemi qitur në pakon tenderuese për ta rritur performancën dhe për ta bërë më atraktive për investitorin. Nëse nuk vlerësohet, sa duhet të jetë çmimi real, “Kosova B”, një kohë do të mbetet kompani e veçantë, pastaj do ta shohim mundësinë që Qeveria të jetë aksionare. Këto janë dy opsionet e mundshme në Strategjinë për periudhën 2009 – 2018, që “Kosova e Re” t’i vazhdojë projektet e saj, ndërsa “Kosova B” të mbetet në pronësi të shtetit. Strategjia parasheh konstatimin e saktë të nevojave dhe të mundësive të prodhimit. Me theks të veçantë foli rreth ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”, me ç’rast theksoi se në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me USAID-in, do të realizohet ky projekt kombëtar.

Fatmir Rexhepi – E bëri një përshkrim të shkurtër dhe tha se të dhënat në kuadër të kësaj strategjie nuk e qartësojnë bazën si do të shkojë puna e Projektit “Kosova e Re”. Strategjia për ndërtimin e kapaciteteve te reja kërkon sqarime se në cilën kohë fillon ndërtimi dhe me çfarë kapacitetesh. “Kosova B” është mirë të renovohet dhe t’i përshtatet ambientit. TC “Kosova B” duhet të mbetet në pronësi të shtetit dhe t’i rregullohet statusi juridik. Në parim e mbështes këtë strategji, me kusht që “Kosova B” të mbetet në pronësi të shtetit.

Myzejene Selmani - Gjatë rishikimit të Strategjisë isha pjesë e grupit të punës. Duke u bazuar në tekstin, që është punuar atëherë dhe në atë që na është paraqitur, po vërej se teksti ka pësuar ndryshime. Tha se “Kosova e Re” duhet të fillojë me kapacitetin prodhues 500 + 500 MV, ndërsa TC “Kosova B” të mbetet në pronësi shtetërore. Ritheksoi se është kundër që TC “Kosova B” të përfshihet në pakon e tenderimit të “Kosovës së Re”.

Kaqusha Jashari – Pati vërejtje se Strategjia e energjisë gjithëherë mbetet barrë e çdo qeverie për ta zgjidhur. Prej fillimit nuk kam qenë për ndërtimin e kapacitetit prej 2000 MV, në veçanti për shkak të ambientit. Sa i përket Strategjisë, mendoj se duhet të përkrahet për arsye ekonomike. Po ashtu për TC “Kosova B”, tha se pajtohet të mbetet në

pronësi të shtetit, nëse për asgjë tjetër, së paku për arsye të pjesëmarrjes në vendimmarrje të nivelizimit të çmimit të energjisë. Theksoi se duhet të preokupohemi edhe me prodhimin, edhe me zgjerimin e kapaciteteve për energji alternative - ndërtimin e hidrocentraleve.

Zef Morina: Tha se duhet të bëjmë investim që i duhet Kosovës dhe jo investim që nuk mund ta rikthejmë. Sa i përket TC “Kosova B”, shprehu shqetësimin përse është përfshirë në Projektin e tenderimit të TC “Kosova e Re”. Po ashtu e ngriti çështjen e afatit për mbylljen e TC “Kosova A”, kurse për TC “Kosova e Re” pyeti për afatet dhe për fazat vepruese. Sipas tij është e rëndësishme të qartësohet ç’mbetet pronë e shtetit nga TC aktuale dhe kërkoi t’i kushtohet rëndësi e veçantë mbrojtjes së ambientit.

Qamile Morina – Gjatë diskutimit u përcaktua në veçanti në mbrojtje të ambientit, si çështje me shumë rëndësi për mbrojtjen e shëndetit. Tha se në funksion të mbrojtjes së shëndetit nuk mbështet projekte me kapacitete të mëdha prodhuese, ndërsa sa i përket TC “Kosova B”, ishte të mbetet në pronësi të shtetit.

Sala Berisha – Shala - Rikujtoi se rishikimi i Strategjisë është detyrim ligjor, që bëhet për çdo tre vjet, ngase tani kemi edhe pakon e projektligjeve për energjinë. E mbështet Strategjinë, por jo nëse bëhen ndryshime radikale. Sa u përket kapaciteteve sa duhet të jenë, pajtohet me atë se duhet të jemi të kujdesshëm për ruajtjen e ambientit sipas standardeve evropiane. I mbështes këto opsione të Qeverisë për fillimin e prodhimit me kapacitet 500 + 500 MV. Shpresoj se kjo strategji do përkrahet.

Kryetarja - I njoftoi anëtarët se më 20. 01. 2010 do të mbahet një konferencë sensibilizuese për investitorët e interesuar për Projektin “Kosova e Re”, që organizohet nga Qeveria. Në të do marrin pjesë, përpos strukturave të tjera, edhe përfaqësues të MEM-i dhe deputetë – anëtarë të Komisionit për ETIETT. Nga kjo konferencë presim të marrim njoftime dhe përfundime nëpërmjet ministres së MEM-it, që do na shërbenin për nxjerrjen e rekomandimit që do t’i procedohet Kuvendit.

Komisioni u pajtua, që edhe në mbledhjen e radhës, të vazhdohet me shqyrtimin e Strategjisë së energjisë për 2009 - 2018.

Temat e tjera të rendit të ditës u shtynë për mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14.30

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani